

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ALBITA ENERGY”**

**KREU I**  
**PËRKUFIZIME**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot, më 12.09.2023, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Albita Energy” Sh.P.K.
2. Themeluesit e shoqërisë janë:
  - Carmelo Grassia, shtetas italian, lindur më 26.07.1966 në Troina (EN), Itali, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër pasaporte YB6470079, banues në Acireale (CT), me pasaportë të vlefshme deri më datë 20.01.2030.
  - Roberto Ligresti, shtetas italian, lindur më 17.05.1969 në Giarre (CT), Itali, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër pasaporte YB5787043, banues në Via Regina Pacis, 6/a, 95014, Giarre, (CA), Itali, me pasaportë të vlefshme deri me datë 10.11.2029.
  - Rezart Kthupi, shtetas shqiptar, lindur më 03.08.1976 në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal H60803159N, banues në Rruga Egnatia, Pallati 1015, Ap 09, Durrës, Shqipëri, me kartë identiteti të vlefshme deri me datë 04.11.2029.
  - Gentian Stambollxhiu, shtetas shqiptar, lindur më 02.02.1972 në Elbasan, Shqipëri, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal H20202066A, banues në Rruga Peti, Kompleksi Cyclades, ap nr 13, Tiranë, Shqipëri, me kartë identiteti të vlefshme deri me datë 26.02.2031.

**Neni 2**

1. Asambleja e ortakëve ka vendosur miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Gjithashtu shoqëria e bazon aktivitetin e saj në Kodin Civil, Kodin e Punës, në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe në ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3**

**Forma**

1. Shoqëria “Albita Energy” sh.p.k është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

**Neni 4**

**Selia**

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës, në adresën Rruga e Kavajës, Kompleksi Square 21, Hyrja 2, Kati 4, Apartamenti 11.
2. Shoqëria ka të drejtë të hapi filiale të tjera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në varësi të selisë Qendrore që ndodhet në qytetin e Tiranës.
3. Vendi i mbajtjes së mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme është selia e shoqërisë. Nëse bihet dakord me shumicë të thjeshtë të ortakëve mbledhjet e asamblesë mund të kryhen në një vend tjetër.

## Neni 5

### Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Ndërtim panelesh fotovoltaike, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, dhe tregtimi i energjisë elektrike.
- Prodhim, transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të paneleve fotovoltaike të rinj apo rehabilitimit të paneleve ekzistues me anë të procedurave të koncensionit, për përmirësim të treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrejtë elektrik kombëtar.
- Ndërtim, depozitim, shfrytëzim i burimeve ujore dhe natyrore me qëllim prodhimin e energjisë elektrike.
- Krijimin e agjensive dhe instituteve për zbatim, kërkim e zhvillim të teknologjive të reja. Krijimin e linjave të prodhimit, të njesive të vogla dhe të mëdha për prodhimin dhe tregtimin e energjisë së prodhuar nga burime natyrore dhe alternative.
- Importim-eksportim, tranzitim, ndërmjetësim, furnizim me energji.
- Importim-eksportim dhe tregtim të linjave të prodhimit dhe teknologjive për prodhimin dhe shfrytëzimin e burimeve energjitike në zbatim të Kontratave të Koncesionit për energji.
- Cdo aktivitet tjetër që nuk ndalohej me ligj.

## Neni 6

### Vula e shoqërisë

1. Shoqëria ka vulën e saj, në brendësi të së cilës shkruhet i plotë emertimi i shoqërisë dhe forma e saj juridike.
2. Te gjitha aktet që dalin nga shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulosen me vulën e shoqërisë.

## Neni 7

### Kohëzgjatja e shoqërisë

1. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

## Neni 8

### Veprimet e lejuara të shoqërisë

1. Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marre Asambleja e Përgjithshme me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit.

## Neni 9

### Marrëdhëniet e punës

2. Shoqëria për të kryer veprimtarinë e saj sipas objektit të këtij statuti do të lidhë kontrata individuale për të rregulluar marrëdhëniet e punës.
3. Kontratat e punës do të lidhen konform ligjit “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” dhe dispozitave të tjera ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

## KREU III

### PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË

## Neni 10

### Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur

1. Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse nuk deklarohen kushtet e veprimit,

si dhe natyrën e objektit e interesit të tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit.

2. Çdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Miratimi i parashikuar jepet, gjithashtu, për çdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë, apo me palë të treta, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipërm janë të tilla që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interesat e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë:
  - a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motrat e bashkëshortit/ bashkëshortes;
  - b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
  - c) personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuarit, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
  - d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë.
4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorum.
5. Çdo veprim që kërkon miratim, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektit e interesit të personave të përfshirë.
6. Për efekt të këtij statuti, me persona të autorizuar për të përfaqësuar ose mbikëqyrur shoqërinë tregtare do të kuptojmë ortakët e shoqërisë, administratorin, ekspertin kontabël të autorizuar dhe likuiduesin e shoqërisë.

#### **Neni 11**

##### **Parimi i besnikërisë**

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose nga ky statut, në rrethana të njëjta, ortakët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

#### **Neni 12**

##### **Ndalimi i konkurrencës**

1. Personat e autorizuar për të përfaqësuar ose mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.
2. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar.
3. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, të mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.
4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:
  - a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
  - b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
  - c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni:
  - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
  - b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
  - c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## KREU IV KAPITALI THEMELTAR – PJESËMARRJA

### Neni 13

#### Kapitali i shoqërisë dhe kuotat

1. Kapitali i shoqërisë ka vlerën 1.000 (një mijë) lekë. Numri i përgjithshëm i kuotave të shoqërisë është 4 (katër).
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal që lejon ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### Neni 14

#### Kontributet

1. Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortaku
2. Carmelo Grassia, i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 250 (dyqind e pesëdhjetë) lekë e cila përfaqson 25% (njëzet e pesë pikë përqindje) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Roberto Ligresti, i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 250 (dyqind e pesëdhjetë) lekë e cila përfaqson 25% (njëzet e pesë pikë përqindje) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Rezart Kthupi, i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 250 (dyqind e pesëdhjetë) lekë e cila përfaqson 25% (njëzet e pesë pikë përqindje) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
5. Gentian Stambollxhiu, i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 250 (dyqind e pesëdhjetë) lekë e cila përfaqson 25% (njëzet e pesë pikë përqindje) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### Neni 15

#### Kalimi i kuotave të kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe të kalueshme në rrugë trashëgimie. Trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi, bëhen ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave të kapitalit.
2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund t'u kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit.
3. Në rast kur njëri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë. Kur ortakët që gëzojnë të drejtën e parablerjes kanë dyshime rreth çmimit të kuotave të ortakut që kërkon të kalojë ato, mund të drejtohen gjykatës që të caktojë një ekspert



vlerësues. Ortaku që kërkon kalimin e kuotave tek të tretët duhet të lajmërohet në një afat sa më të shpejt, nëse brenda 4 javëve ortakut nuk i jepet një përgjigje atëherë prezumohet se ortakët e tjerë kanë rënë dakord që kuotat e tij mund ti kalohen të tretëve.

4. Kalimi i kuotave do të bëhet me kontratë.
5. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

#### Neni 16

1. Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

### KREU V ORGANET E SHOQËRISË, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE

#### Neni 17

##### Asambleja e përgjithshme

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë.
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertët kontabël të autorizuar, po qe se ka të tillë, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Këta ortakë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë, ose nëpërmjet postës elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
  - c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve, të ekspertëve kontabël të autorizuar dhe të këshilltarëve juridikë;
  - d) Emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve të sektorit juridik dhe atij të financës;
  - e) Përcaktimin e shpërblimeve për subjektet e pikave b), c) dhe d).;
  - f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës);

- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës);
  - i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji ose nga Statuti.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
11. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) Investime;
  - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e Asamblesë konsiderohen të miratuara kur për to ka votuar shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit themeltar.
13. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë pikë, të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 18

##### Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizikë të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblesë së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.
5. Administrator i shoqërisë për periudhën 12.09.2023 – 11.09.2028 emërohet Roberto Ligresti, shtetas italian, lindur më 17.05.1969 në Giarre (CT), Itali, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër pasaporte YB5787043, banues në Via Regina Pacis, 6/a, 95014, Giarre, (CA), Itali, me pasaportë të vlefshme deri me datë 10.11.2029.

#### Neni 19

##### Kompetencat e administratorëve

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme përpara parashikon ky statut ose ligji.
  3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin/ët në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

#### **Neni 20**

##### **Kufizimet e administratorëve**

1. Administratori/administratorët e shoqërisë pa miratimin me vendim nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të:
  - a. Lidhin kontrata, marrin përsipër detyrime apo shlyejnë pagesa të cilat tejkalojnë vlerën prej 10.000.000 (dhjetë milion) lekësh apo ekuivalentin e kësaj shumë në monedhë të huaj apo në cdo formë tjetër të konvertueshme.
  - b. Lidhin kontrata, marrin përsipër detyrime apo shlyejnë pagesa, të cilat, gjatë kohëzgjatjes 1 vjecare e ngarkojnë shoqërinë me detyrime që tejkalojnë vlerën prej vlerën prej 5.000.000 (pesë milion) lekësh apo ekuivalentin e kësaj shumë në monedhë të huaj apo në cdo formë tjetër të konvertueshme.
2. Për marrjen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për autorizimin dhe miratimin e kërkesës përkryerjen e veprimeve të kufizuara ndiqen rregullat e parashikuara në nenin 18 të këtij Statuti.

#### **Neni 21**

##### **Ekspertë kontabël të autorizuar**

1. Në rast nevojë si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli financiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e përgjithshme me shumicë të zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

#### **KREU VI**

##### **VOTA**

#### **Neni 22**

##### **E drejta e votës**

1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Çdo ortak votat që ka mund ti japi vetëm në uniformitet.

#### **Neni 23**

##### **E drejta për të kaluar rezolutë**

1. Asambleja e përgjithshme mund të miratojë rezolutë pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj. Që të miratohet një rezolutë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të jenë të pranishëm të gjithë ortakët personalisht dhe ta votojnë atë në mënyrë të unifikuar.

#### **KREU VII**

##### **MARREDHËNIET FINANCIARE**

#### **Neni 24**

##### **Viti financiar**



1. Çdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

#### **Neni 25**

##### **Bilanci vjetor**

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme e zakonshme.
2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej tre muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.
3. Gjuha që përdoret në hartimin e dokumentave vjetore është gjuha shqipe.

#### **Neni 26**

##### **Dividentet**

1. Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin në raport me kuotat që gjithsecili ka në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në raport me kuotat, përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (5 % e fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 27**

##### **Marrëdhëniet me bankat dhe institutet financiare**

1. Shoqëria ka të drejtë të hapë llogari likuiduese pranë një ose më shumë bankave ose institucioneve financiare dhe të mund të kryejë veprime likuiduese pranë bankave. Në këto banka ose institute financiare si nënshkrim i parë do të depozitohet ai i administratorit të shoqërisë, i cili duhet të nënshkruajë për të gjitha veprimet financiare në emër e për llogari të shoqërisë. Ai mund të autorizojë edhe persona të tjere brenda shoqërisë.

#### **Neni 28**

##### **Marredhënia me organet tatimore**

1. Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron me 31 dhjetor të çdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklarin e të ardhurave, dhe t'i depozitojnë ato pranë organit përkatës të tatimeve.

### **KREU VIII DISPOZITA TË TJERA**

#### **Neni 29**

##### **Mosmarrëveshjet**

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit midis ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do zgjidhen me arbitrazh. Institucioni i arbitrazhit do të jetë Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit. Rregullat e arbitrazhit do të jenë rregullat procedurale të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit. Mosmarrëveshjet do të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm, i cili do të caktohet nga Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit, sipas procedurave të këtij institucioni për caktimin e arbitrit të vetëm. Legjislacioni që do të zbatohet gjatë gjykimit në arbitrazh do të jetë legjislacioni shqiptar.

#### **Neni 30**

##### **Të fundit**





1. Për çështje që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**Neni 31**  
**Të fundit**

1. Ky statut përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe, në Tiranë sot më datë 12/09/2023.

Ky statut nënshkruhet nga ortakët

**ORTAKËT**

**CARMELO GRASSIA**



**ROBERTO LIGRESTI**



**REZART KTHUPI**



**GENTIAN STAMBOLLXHIU**

